



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. prot.

Tiranë, më 26. 09.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion, datë 13.9.2022

ZNJ. B C

TELEVIZIONI “V. P. ”

Adresa postare: Rruga ”,

Të dhëna kontakti: e-mail:

E nderuar znj. C

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, dërguar datë 13.9.2022, protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. prot., datë 13.9.2022, ju informojmë se:

Nga data 8 shkurt 2018, deri në **datën 16 shtator 2022**, janë dhënë **557 vendime**, nga të cilat:

- **215** vendime për konfirmimin në detyrë të **107** gjyqtarëve, **96** prokurorëve, **2** ish-inspektorëve në KLD, **1** inspektori në KLGJ dhe **9** ndihmësve/këshilltarë ligjorë;
- **209** vendime për shkarkimin nga detyra të **124** gjyqtarëve, **81** prokurorëve, **1** inspektori në ILD, **1** inspektori në KLGJ dhe **2** ndihmësve ligjorë;
- **83** vendime për ndërprerje të procesit për **52** gjyqtarë, **21** prokurorë, **2** ish-inspektorëve në KLD dhe **7** ndihmësve ligjorë + **1** ish-prokurori (Neni 6 i Aneksit të Kushtetutës);
- **8** vendime për pushimin e procesit për **3** gjyqtarë, **1** prokuror dhe **4** ndihmës ligjorë në Gjykatën e Lartë (Neni 56 i Ligjit nr. 84/2016);
- **38** vendime për përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar për **23** gjyqtarë, **13** prokurorë, **1** ish- Kryeinspektor të KLD-së dhe **1** ish-Inspektor të ILD-së (Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative dhe Neni 64 i Ligjit nr. 96/2016);
- **4** vendime për pezullimin nga detyra të **3** prokurorëve dhe **1** ndihmëse ligjore.

Statistikat e përditësuara mund t’i gjeni periodikisht në faqen zyrtare të KPK-së, përmes këtij linku <https://kpk.al/statistika/>.

Nga 209 subjekte të shkarkuar, 140 prej tyre janë shkarkuar bazuar në 18 tre kritere të rivlerësimit, 17 subjekte janë shkarkuar bazuar në 2 kritere, atë pasuri dhe figurë ose profesional. Ndërsa, vetëm me 1 kriter, janë shkarkuar nga detyra 51 subjekte rivlerësimi.

Lidhur me dy pyetjet e fundit, se sa prej subjekteve të shkarkuar janë referuar në SPAK, Komisioni e gjen me vend të shpjegojë në frymën e parimeve kushtetuese ligjore dhe ato të procesit të rregullt ligjor, se:

Procesi i vetingut realizohet në shkallën e parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe, në shkallën e dytë, nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, si shkalla më e lartë e gjyqimit në sistemin gjyqësor shqiptar dhe dhomë e posaçme pranë Gjykatës Kushtetuese.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, Nenin Ç të Aneksit të saj, si dhe neneve 63-66 të ligjit nr. 84/2016, vendimet e Komisionit nuk janë të formës së prerë, pasi subjektet dhe/ose Komisionerët Publikë kanë të drejtë ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Vendimi i Kolegjit, që vendos shkarkimin nga detyra të subjekteve është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm *ex-lege*. Të gjithë subjektet që dalin nga sistemi me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, me vendim të formës së prerë, u ndalohej gjithashtu e drejta e kandidimit brenda sistemit të drejtësisë për 15 vjet. Ky ndalim vlen edhe për subjektet e dorëhequr nga detyra, të cilëve u ndërpritet procesi i rivlerësimit kalimtar, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës.

Duke ju falenderuar, urojmë punë të mbarë!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Edmond Verçani

